



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:212760
Datë: 26.12.2024
Numri i dokumentit: 06652639

K.DH.Shk.II.nr.2157/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, Gjyqtari Dren Rogova, në çështjen përmbartimore të kreditorit “DARDAFON.NET” L.L.C, me NUI: 810745416, me seli në fshatin Miradi e Epërme, Rruga “Dëshmori” p.n., Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Faton Qirezi, avokat në Prishtinë, ndaj debitorit Telekom i Kosovës SH.A., me NUI: 811288001, me seli në Prishtinë, Lagjja Dardania p.n., të cilën e përfaqëson Burbuqe Hana, për shkak të përmbartimit sipas dokumentit përmbartimor – vendimit të arbitrazhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1137/24 të datës 02.10.2024 dhe aktvendimit KPPP.nr.1137/24 të datës 16.10.2024, me datë 26.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET SI E PABAZUAR ankesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1137/24 i datës 02.10.2024, VËRTETOHET.
- II. REFUZOHET SI E PABAZUAR ankesa e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1137/24 i datës 16.10.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin KPPP.nr.1137/24 i datës 02.10.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë në pikën I të dispozitivit është refuzuar si i pabazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.415/24, të datës 19.07.2024, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj. Në pikën II të dispozitivit, është lënë në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.415/24, i datës 19.07.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ka parashtruar ankesë debitori Telekom i Kosovës Sh.A., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me

ankesë debitori ka propozuar që të aprovohet ankesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPP.nr.1137/24 dt.02.10.2024, ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPP.nr.1137/24 dt.02.10.2024 ashtu që aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dt.25.07.2024 dhe anulohet urdhri përmbarrimor P.nr.415/24 dt.19.07.2024 i Përmbarruesit Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë dhe shfuqizohen/abrogohen të gjitha veprimet përmbarrimore të ndërmarra nga i njëjti, ose alternativisht të prishë aktvendimin e Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPP.nr.1137/24 dt.02.10.2024 dhe lënda t’i kthehet në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale – Dhomës së Shkallës së Parë.

Kreditori përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka propozuar refuzimin e ankesës dhe vërtetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë

Debitori Telekom i Kosovës me datë 14.10.2024 ka parashtruar në Dhomat e Shkallës së Parë kërkesë për shtyrje të ekzekutimit. Sipas kërkesës debitori pretendon se me datë 03.10.2024 i është drejtuar përmbarruesit privat, ku ka kërkuar që të shtyhet përmbarrimi në këtë çështje pasi që ekzekutimi do t’i sillte dëm të pariparueshëm debitorit.

Duke vendosur sipas kërkesës së debitorit për shtyrje të ekzekutimit, Dhoma e Shkallës së Parë me aktvendimin KPPP.nr.1137/24 dt.16.10.2024, në pikën I. të dispozitivit është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas kërkesës së debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., për shtyrje të përmbarrimit në lëndën përmbarrimore sipas Urdhrit Përmbarrimor P.nr.415/24 dt.19.07.2024, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit është hedhur poshtë si e palejuar kërkesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., për shtyrje të përmbarrimit në lëndën përmbarrimore sipas Urdhrit Përmbarrimor P.nr.415/24 dt.19.07.2024 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë debitori Telekom i Kosovës Sh.A., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurë, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me ankesë debitori ka propozuar që të aprovohet ankesa e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPP.nr.1137/24 dt.16.10.2024, të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KPP.nr.1137/24 dt.16.10.2024 ashtu që aprovohet në tërësi si faktikisht dhe ligjërisht e bazuar kërkesa e debitorit për shtyrjen e përmbarrimit dhe të shtyhet përmbarrimi i urdhrit përmbarrimor P.nr.415/24 i datës 19.07.2024 deri në vendosjen meritorë në këtë çështje juridike përmbarrimore sipas padisë së anulimit të vendimit të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të tregtisë (ICC) 24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022.

Gjykata nuk ka dëshmi se kreditori ka parashtruar përgjigje në këtë ankesë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “DARDAFON.NET” L.L.C., në bazë të dokumentit përmbartimor – Vendimi i Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022, i njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas Aktvendimit me numër KE.nr.2142/22 të datës 08.07.2024, ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.415/24, të datës 19.07.2024, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit “TELEKOMI I KOSOVËS”, SH.A., dhe ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Urdhri, t’ia paguaj kreditorit “DARDAFON.NET” L.L.C., shumën prej 10,270,400.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 22.10.2019, e deri në pagesën definitive, si dhe ka detyruar debitorin “TELEKOMI I KOSOVËS”, SH.A., që në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Urdhri, në emër të kostove ligjore dhe në emër të kostove të arbitrazhit, t’ia paguaj kreditorit “DARDAFON.NET” L.L.C., shumën prej 1,393,812.57 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, duke filluar 30 ditë pas njoftimit të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit 18.02.2022, e deri në pagesën definitive. Të gjitha pagesat të realizohen në llogarinë bankare të kreditorit në NLB-Prishtina 1706001011378224, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Në rast se debitori nuk ka mjete të mjaftueshme financiare në xhironlogaritë bankare, përmbartimi i dhunshëm të realizohet përmes mjeteve financiare nga shitja e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin për përmbartim, debitori Telekom i Kosovës kishte paraqitur prapësim me të cilën pretendon se me dt. 16.05.2022, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për Anulimin e Vendimit të Arbitrazhit, me numër të rastit ICC NR.24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022, e cila evidentohet me numrin KE.nr.151/24, ndërsa kreditori me datë 23.03.2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike ka paraqitur propozim për Njohjen dhe Shpalljen të Ekzekutueshëm të Vendimit të Arbitrazhit, me numër të rastit ICC NR.24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022, e cila evidentohet me numrin KE.nr.2142/22. Ka shtuar se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me datë 27.03.2024, me Aktvendimin KE.nr.151/24, është shpallur jo kompetente në pikëpamje absolute për të vendosur sipas padisë së paditësit Telekom i Kosovës dhe e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e paditësit. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin Kom.DH.II.nr.954/24, të datës 24.05.2024, ka refuzuar ankesën e debitorit dhe ka vërtetuar Aktvendimin KE.nr.151/24, të datës 27.03.2024, të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë. Sipas prapësimit debitori pretendon se ndaj Aktvendimit Kom.DH.II.nr.954/24, të datës 24.05.2024, debitori ka paraqitur Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të cilin ende nuk është vendosur. Meqenëse debitori ka paraqitur prova konkrete, bëhet i besueshëm fakti se i njëjti do të ketë sukses pranë Gjykatës Supreme në procedurën sipas revizionit, duke i urdhëruar të dyja shkallët e Gjykatës Komerciale të shqyrtojnë padinë për anulimin e vendimit të arbitrazhit, pasi që Gjykata Komerciale është kompetente për trajtimin e padisë së tillë. Sipas prapësimit debitori pretendon se me datë 12.07.2024, ka dorëzuar përmes email kërkesën për përmbushjen vullnetare të Vendimit të Arbitrazhit, me një afat të përgjigjes prej 7 ditësh, i cili do të përfundonte me datë

19.07.2024, të cilës debitori i është përgjigjur me datë 19.07.2024, me qëllim të aranzhimit të një takimi për diskutim në mes palëve dhe për gjetjen e zgjidhjes dhe përkundër këtij fakti, debitori ka pranuar nga Përmbaruesi Privat propozimin për përmbarim të kreditorit, të lejuar sipas urdhrin përmbarimor P.nr.415/24 të datës 19.07.2024.

Pas shqyrtimit të prapësimit, gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1137/24 të datës 02.10.2024 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Telekomit i Kosovës SH.A., të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.415/24, të datës 19.07.2024, të Përmbaruesit Privat Flamur S. Bogaj. Në pikën II të dispozitivit, është lënë në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.415/24, i datës 19.07.2024, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj.

Sipas aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, prapësimi i debitorit është i pabazuar, për faktin se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) – Vendimit të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HHB, të datës 18.02.2022, të njohur dhe të shpallur i ekzekutueshëm nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas Aktvendimit me numër KE.nr.2142/22 të datës 08.07.2024. Deri tek kjo vendosje gjykata e shkallës së parë ka ardhur bazuar në dispozitat e Nenit 21, 22 par.1, pika 1.5, 23 par.1, 24 par 1 e LPP-së, si dhe Nenit 39 të Ligjit mbi Arbitrazhin. Andaj, bazuar në dispozitat e LPP-së gjykata e shkallës së parë erdhi në përfundim se urdhri për përmbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv - Vendimi përfundimtar të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HHB, të datës 18.02.2022, i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore për përmbarimin e të njëjtit, pasi që dokumenti përmbarimor, është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe i njëjti vendim është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm me datën 08.07.2024.

Ndërkaq, gjykata e shkallës së parë lidhur me kërkesën e debitorit për shtyrje të përmbarimit , ka vendosur si në aktvendimin KPPP.nr.1137/24, dhe atë: në pikën I. të dispozitivit është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas kërkesës së debitorit Telekomit i Kosovës Sh.A., për shtyrje të përmbarimit në lëndën përmbarimore sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.415/24 dt.19.07.2024, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit është hedhur poshtë si e palejuar kërkesa e debitorit Telekomit i Kosovës Sh.A., për shtyrje të përmbarimit në lëndën përmbarimore sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.415/24 dt.19.07.2024 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë. Deri te kjo vendosje gjykata e shkallës së parë erdhi bazuar në dispozitat e Nenit 61. Par.1 dhe 3 të LPP-së, ashtu që ka konkluduar se për të vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje të përmbarimit është organi përmbarues – përkatësisht Përmbaruesi Privat i cili e ka lejuar përmbarimin, ndërsa përjashtimisht gjykata sipas Nenit 61 pika 11 të LPP-së.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore të parashtuara me ankesat e debitorit, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesat e debitorit janë të pabazuara:

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi se Gjykata e shkallës së parë në bazë të dokumentit përmbartimor, provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Vendosjen e Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë duke vlerësuar se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, pika b), g), j) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përmbartimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, vlerësojnë se Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë prapësimin e debitorit, si dhe urdhrin për përmbartim të bazuar në dokumentin përmbartimor, e po ashtu edhe provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes ne aktvendimin e ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes në këtë çështje përmbartimore sipas prapësimin, drejtë ka konstatuar faktin se urdhri për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit privat bazohet në dokumentin përmbartimor (titullit ekzekutiv) – Vendimit të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022, i njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas Aktvendimit me numër KE.nr.2142/22 të datës 08.07.2024. Më tutje, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se sipas dokumentit përmbartues - Vendimit të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022, është konstatuar se Marrëveshja për Mbështetjen e Operatorit të Rrjetit Virtual Mobil ndërmjet Telekomit të Kosovës SH.A., dhe Dardafon.net SH.P.K., e datës 16.01.2019, ka skaduar me datë 30.07.2019; është konstatuar se Telekomit të Kosovës SH.A., ka shkelur detyrimin sipas nenit 3.1 të MSA-së për të negociuar një Marrëveshje të re për Mbështetjen e Operatorit të Rrjetit Virtual Mobil me mirëbesim; është obliguar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 7,590,400.00 € në emër të fitimit të humbur, si dhe shumën prej 2,680,000.00 €, në emër të dëmeve të likuiduara, të gjitha këto me kamatë prej 8% duke filluar nga data 22.10.2019 e deri në përmbushjen definitive; është obliguar debitori që kreditorit t’ia paguaj shumën prej 1,290,770.67 € në emër të kostove ligjore dhe kostove tjera dhe shumën prej 117,000.00 \$, në

emër të kostove të arbitrazhit, me kamatë prej 8% në vit e cila do të filloj të llogaritet 30 ditë pas njoftimit të vendimit përfundimtar të arbitrazhit. Ky vendim ka fuqinë e titullit ekzekutiv në procedurën përmbarimore, pasi që i njëjti është njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm sipas Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me numër KE.nr.2142/22 të datës 08.07.2024.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar shkeljet esenciale të natyrës absolute të dispozitave të procedurës, të cilat gjykata i heton sipas detyrës zyrtare, vije në përfundim se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje absolute nga Neni 182 par.2) të LPK-së, pasi që në rastin konkret përmbarimi bazohet në dokument përmbarues – vendim të arbitrazhit, i cili në këtë procedurë paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 22 par. 1.5 të LPP-së. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se vendim i arbitrazhit e ka fuqinë e dokumentit përmbarues pasi që i njëjti ka kaluar procedurën e njohjes siç kërkohet me dispozitatat e nenit 22 par.1 pika 1.5 të LPP, lidhur me Nenin 39 të Ligjit për Arbitrazhin.

Po ashtu, dokumenti përmbarues mbi bazën e të cilit zbatohet përmbarimi – Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HBH, të datës 18.02.2022, i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit nga Neni 27 par.1 i LPP-së, ngase në vendimin e arbitrazhit janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbarje nga ana e debitorit, koha e përmbarjes së këtij detyrimi dhe i njëjti vendim është njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm.

Gjykata i shqyrtoi pretendimet ankimore lidhur me shkeljet esenciale të ngritura me ankesë, mirëpo gjeti se debitori përpos parafrazimit përgjithësues të fakteve, debitori nuk ka përcaktuar asnjë shkelje konkrete të dispozitave të natyrës relative e cila do të përbente bazë për prishjen e aktvendimit. Andaj, bazuar në të lartcekurat Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësojnë se aktvendimi i atakuar nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës të natyrës absolute, e të cilat mund të jenë arsye për prishjen e aktvendimit të atakuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Dhoma e Shkallës së Dytë çmon se aktvendimi i atakuar në mënyrë të plotë ka trajtuar pretendimet e debitorit brenda kufijve të shkaqeve ligjore nga Neni 69 i LPP-së. Në këtë drejtim, referuar pretendimeve ankimore të debitorit për paraqitjen e revizionit në procedurën kontestimore, e cila sipas ankesës pretendon se paraqet çështje paraprake, kjo Gjykatë vije në përfundim se fakti që një palë në procedurë të përmbarimit paraqet revizion në një proces kontestimor, të ndërlidhur me dokumentin përmbarimor, nuk paraqet shkak e as pengesë ligjore për zbatimin e përmbarimit. Duhet nënvizuar se përmbarimi në këtë çështje zbatohet mbi bazën e një dokumenti përmbarimor – vendim përfundimtar të arbitrazhit, i cili e ka kaluar procedurën e njohjes së vendimit të huaj nga gjykata kompetente në Republikën e Kosovës. Së këndejmi, gjykata me rastin e trajtimit të prapësimit me të drejtë ka shqyrtuar vetëm rregullsinë formale të propozimit për përmbarim. Kështu, edhe Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se vendimi i një

arbitrazhi ndërkombëtar si procedurë alternative të cilës palët i janë nënshtruar me vullnetin e tyre të lirë, paraqet titull ekzekutiv për palët në procedurë dhe organi përbarues e as gjykata në shqyrtimin e prapësimit nuk ka tagër ligjor që në çfarëdo mënyre të anulojë, shtyjë apo në çfarëdo mënyrë të anashkalojë përbarimin e bazuar në një dokument përbarues juridikisht të rregullt. Rrjedhimisht, revizioni si mjet i jashtëzakonshëm në çfarëdo procesi kontestimor, jo vetëm se nuk e ndalon ekzekutimin në kuptim të Nenit 213 të LPK-së, por as nuk paraqet shkak ligjor për prapësim nga Neni 71 i LPP-së.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar me të drejtë ka trajtuar dokumentin përbarimor vetëm në kuadër të plotësimin të kushteve ligjore të përbarimit e që në rastin konkret për qëllim të zbatimit të përbarimit është i mjaftueshëm fakti se propozimi për përbarim mbështetet në dokumentin përbarues - Vendimin përfundimtar të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me numër 24841/MHM/HH, i datës 18.02.2022, i cili dokument i ka tiparet e përbarueshmërisë dhe është dokument i përshtatshëm për përbarim. Vendimi i arbitrazhit i plotëson edhe kushtet në kuptim të Nenit 38 par.1 i LPP-së dhe gjykata e shkallës së parë mjaftueshëm ka ekzaminuar se i njëjti është dorëzuar në kopje të vërtetuar, së bashku me përkthim të certifikuar në gjuhën shqipe dhe i plotëson kushtet ligjore për të qenë i përbarueshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të ngritura me ankesë lidhur me: pretendimet që i referohen revizionit; besueshmërisë se kërkesa për revizion do të ketë sukses, si kusht për shtyrje të përbarimit; pretendimit se kreditori asnjëherë nuk ka paraqitur për njohje ndonjë vendim të ndonjë gjykate të Londrës i cili do të ishte i vlefshëm për referencë në Republikën e Kosovës; pretendimet për sigurinë juridike dhe të drejtës për gjykim të drejtë.

Duhet theksuar se të gjitha këto pretendime që ndërlidhen me procedurat e tjera të ndara nga përbarimi në këtë çështje juridike, qoftë kontesti për shkak të padisë së anulimit të vendimit të arbitrazhit dhe/apo procedura për njohje të vendimit të huaj të arbitrazhit, përfshirë këtu mjetet e jashtëzakonshme të shfrytëzuara nga debitori, nuk paraqesin shkaqe për prapësim, rrjedhimisht as arsye për ankesë në këtë procedurë. Kjo për faktin se arsyet për këto pretendime janë dhënë nga gjykatat në procedurat përkatëse për çështjet e ngritura, andaj Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se objekt ankimi mund të jenë vetëm çështjet që i takojnë diskrecionit të kësaj procedure përbarimore. Gjykata vlerëson se nuk i takon juridiksionit të saj dhe nuk hyn në domenin e kësaj Gjykate që të trajtojë pretendimet ankimore të cilat debitori i ka parashtruar lidhur me procedurat tjera apo shkeljet e pretenduara në to, për shkak se arsyet për këto pretendime janë dhënë nga gjykatat në procedurat përkatëse për çështjet e ngritura.

Rrjedhimisht, lidhur me këto pretendime, e duke iu referuar gjykimit të drejtë në dritë të Nenit 31 të Kushtetutës dhe Nenit 6 të KEDNJ, duhet theksuar se Neni 6 par. 1 i KEDNJ-së detyron gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument (Shih për këtë, rasti *Van de Hurk kundër Hollandës*, par 61; rasti *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], par 26; rasti *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*). Shtrirja

e detyrimit të arsytimit mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit (rasti *Ruiz Torija k. Spanjës*, par. 29 ; *Hiro Balani k. Spanjës*, par. 27) dhe duhet të analizohet në dritën e rrethanave të rastit : veçanërisht duhet mbajtur parasysh larmia e mjeteve që një ndërgjyqës mund të ngrejë para drejtësisë [...] (rasti *Ruiz Torija k. Spanjës*, par 29 ; rasti *Hiro Balani k. Spanjës*, par 27).

Përkitazi me këtë, kjo Gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të cilat konsistojnë me pretendimet ndaj procesit kontestimor të udhëhequr lidhur me njohjen e vendimit të huaj, respektivisht padisë për anulimin e vendimit, janë objekt shqyrtimi dhe i takojnë juridiksionit të Gjykatave përkatëse në atë procedurë. Kur kemi të bëjmë me përmbarrimin në këtë çështje juridike, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se kompetenca e saj është e kufizuar vetëm në pretendimet rreth ligjshmërisë së përmbarrimit sipas titullit ekzekutiv dhe tipareve të përmbarrueshmërisë. Së këndejmi, duhet ri-përsëritur se gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi i drejtë se me Nenin 39 të Ligjit për Arbitrazhin është përcaktuar se vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës, njihen nga Gjykatat e Kosovës si të plotfuqishme dhe të njëjtat ekzekutohen, nëse ato vendime janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshme. Ndërlidhur me këtë, Neni 22 i LPP-së, i përcakton vendimet e arbitrazhit të huaj të cilat janë pranuar për përmbarrim brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dokumente përmbarrimore në bazë të të cilave organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin.

Dhoma e Shkallës së Dytë përsërit se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka pasur tagër të trajtojë vetëm pretendimet e prapësimit ndërlidhur me ligjshmërinë e përmbarrimit, e cila me të drejtë duke u kufizuar në shkaqet e prapësimit, ka ardhur ne përfundim se Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm sipas Aktvendimit KE.nr.2142/22 të datës 08.07.2024 dhe si rrjedhojë i plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 22 të LPP-së. Më tej, gjykata e shkallës së parë kur i referohet pretendimit se Aktvendimi KE.nr.2142/22 i datës 08.07.2024, nuk ka marr formën e prerë dhe ndaj të njëjtit nuk ka kaluar/skaduar, as afati partitiv për përmbushje vullnetare, me të drejtë konkludon se vendimet të cilat nuk mund të goditen me ankesë bëhen të formës së prerë sa i përket çështjes së vendosur me të njëjtin vendim, në kuptim të Nenit 166 par.1 të LPK-së.

Referuar fakteve të çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë gjen se aktvendimi i atakuar përmban arsye të mjaftueshme përtej shkaqeve të paraqitura me prapësim duke dhënë arsye konkrete në të gjitha pretendimet relevante të debitorit, përfshirë këtu edhe faktin se nuk paraqet bazë për prapësim nga Neni 71 par.1 pika 1.2 të LPP-së, vetëm mundësia e prishjes, anulimit apo shfuqizimit të dokumentit. Pra, në mënyrë që kjo dispozitë të gjej zbatim, dokumenti në bazë të cilit është marr urdhri përmbarrues duhet të jetë prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë të ketë humbur efektin e tij, që të mund të përbëj shkak/bazë për paraqitjen e prapësimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë përtej argumenteve të ngritura nga debitori, e me qëllim që të jep arsye rreth rezultatit të këtij procesit, e sheh të nevojshme që të ritheksojë se përmbarrimi në këtë çështje bazohet mbi titull ekzekutiv – vendimin përfundimtar të arbitrazhit ndërkombëtar, i cili i

plotëson kriteret ligjore për përmbarim dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, përfshirë këtu kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.5, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së dhe nenit 39 të LA-së. Kjo për faktin se dokumenti përmbarimor, është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbarje nga ana e debitorit, koha e përmbarjes së këtij detyrimi dhe i njëjti vendim është njohur dhe është shpallur i ekzekutueshëm nga gjykata vendore.

Në raport me vendimet e arbitrazhit edhe GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se "posedimet" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 mund të jenë ose "pasuri ekzistuese" (shih Van der Mussele kundër Belgjikës, 23 nëntor 1983, Seria A nr. 70, f. 23 , § 48) ose asete, duke përfshirë pretendimet, në lidhje me të cilat një aplikant mund të argumentojë se ai ka të paktën një "pritje legjitime" që ato do të realizohen (shih, për shembull, Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës, aktgjykimi e 20 nëntorit 1995, Seria A nr. 332, f. 21, Ouzounis dhe të tjerët kundër Greqisë, 18 prill 2002 par. 24; Ostapenko kundër Ukrainës, 14.09.2007, par.44).

Në këtë drejtim, çfarëdo qëndrimi që do të devijonte qëllimin e procedurës përmbarimore, nën pretekstin e argumentimeve që nuk i takojnë ligjshmërisë së kësaj procedure, paraqet tejkalim të drejtave dhe detyrimit të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore ashtu siç janë. Andaj, meqë aktvendim i Tribunalit të Arbitrazhit sipas të cilit është iniciuar kjo procedurë përmbarimore, i plotëson kriteret për lejimin e ekzekutimit të tij dhe paraqet dokument përmbarimor të ligjshëm, Dhoma e Shkallës së Dytë gjejnë se lidhur me këtë çështje përmbarimore nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së. Nga të lartcekurat gjykata vie në përfundim se aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Parë KPPP.nr.1137/24 i datës 02.10.2024, nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës, andaj ankesa e debitorit ndaj këtij aktvendimi u refuzua si e pabazuar.

Duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të debitorit lidhur me ankesën ndaj aktvendimit KPPP.nr.1137/24 të dt.16.10.2024, për shtyrje të përmbarimit, Dhoma e Shkallës së Dytë pas shqyrtimit të aktvendimit të atakuar, pretendimeve ankimore të debitorit dhe shkresave të lëndës, erdhën në përfundim se ankesa e debitorit është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e vendosjes për shtyrje të përmbarimit drejtë kanë konstatuar se kërkesa e debitorit është e palejuar pasi që nga dispozita e Nenit 61 të LPP-së, rrjedh detyrimi i organit përmbarues për të vendosur rreth kërkesës së palës për shtyrje të përmbarimit. Në rastin konkret, procedura përmbarimore është iniciuar dhe urdhri për përmbarim është lëshuar nga përmbaruesi privat, dhe nuk kemi të bëjmë me përmbarim gjyqësor ku gjykata paraqitet si organ përmbarues. Rrjedhimisht, fakti se përmbarimi zbatohet nga përmbaruesi privat, i njëjti si organ përmbarues është kompetent për të vendosur rreth shtyrjes së përmbarimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë pa paragjykuar nëse janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrje të përmbarimit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka hedhur poshtë si të palejuar kërkesën e debitorit për shtyrje të përmbarimit, ngase gjykata fare nuk është kompetente për të vendosur rreth shtyrjes së përmbarimit të zbatuar nga përmbaruesi privat. Kjo gjykatë ka shqyrtuar pretendimet ankimore të debitorit, mirëpo vlerëson se autoriteti gjyqësor në këtë rast nuk ka tagër për të shtyrë përmbarimin përderisa nuk vepron si organ përmbarues, por vetëm si instancë gjyqësore në trajtimin e prapësimit. Rrjedhimisht, kushteve ligjore të përcaktuara me Nenin 61 të LPP-së nuk mund t'i jepet interpretim duke u kufizuar vetëm në paragrafin 11, por dispozita duhet interpretuar si tërësi e normës. Kështu, rregulli nga paragrafi 1 i Nenit 61 të LPP-së i jep kompetencë organit përmbarues për të vendosur për shtyrjen e përmbarimit. Në këtë rast organ përmbarues paraqitet përmbaruesi privat dhe nuk kemi të bëjmë me përmbarimin nga gjykata. Dispozita e Nenit 61 ku si kompetente për shtyrje të përmbarimit është gjykata, vije në shprehje vetëm në rastet kur gjykata shërben si organ përmbarues dhe e zbaton përmbarimin. Andaj, duke qenë se në këtë çështje juridike gjykata ka vetëm rol në trajtimin e prapësimit dhe përmbaruesi privat e zbaton përmbarimin, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të jokompetencës absolute gjyqësore.

Nga të lartcekurat, Dhoma e Shkallës së Dytë erdhën në përfundim se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe provat e bashkangjitura nuk mund të gjejnë trajtim në një çështje ku gjykata nuk ka kompetencë gjyqësore për të trajtuar aspektet e shtyrjes së ekzekutimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.2157/24, me datë 26.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova